



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE**  
**LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**  
**KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM**

**Nr. 12 , datë 30.03.2017**

**Mbi tarifat e ujit për konsum publik  
për shoqërinë UK Gjirokastrë Qytet Sha**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, te Ligjit Nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, Metodologjisë "Për vendosjen e tarifave" Komisioni Kombëtar Rregullator,

**VENDOSI:**

**1. Miratimin e tarifave për shoqërinë U K Gjirokastrë Qytet Sha :**

**a. Tarifë volumetrike për shërbimet:**

	<b>Furnizim me ujë</b>	<b>Largimi i ujërave të ndotura</b>
Konsumator familjar	43 lekë/m <sup>3</sup>	10 lekë/m <sup>3</sup>
Konsumator publik	125 lekë/m <sup>3</sup>	16 lekë/m <sup>3</sup>
Konsumator privat	130 lekë/m <sup>3</sup>	16 lekë/m <sup>3</sup>

**b. Tarifë fikse**

Konsumator familjar	80 lekë/muaj/klient
Konsumator publik	80 lekë/muaj/klient
Konsumator privat	80 lekë/muaj/klient

**2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2017:**

➤ uji pa të ardhura (humbjet)	64 %
➤ niveli i matjes	76 %
➤ kohëzgjatja e furnizimit	6 orë/ditë
➤ efiçenca e energjisë	0.6 kwh/m <sup>3</sup>
➤ efiçenca e stafit	6.7 p/000/lidhje
➤ mbulimi me ujë	100 %
➤ mbulimi me kanalizime	65 %
➤ norma e arkëtimit	93 %
➤ cilësia e ujit (klor + koliform)	sipas standarteve

3. Pagesa rregullatore vjetore për UK Gjirokastër Qytet Sha do të jetë 0.6% e të ardhurave të llogaritura.
4. Vendimi KKRR nr.44, datë 27.12.2013 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Sha U K Gjirokastër qytet" shfuqizohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi më 01.04.2017 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI**  
**Ndriçim SHANI**